K.B

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA LEZHË

Nr. 7616/6 Prot. Lezhë, më 14/10/2026

PROCES-VERBAL

KONSULTIM PUBLIK NË LIDHJE ME PROJEKT- VENDIMI "PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NUMËR 18 DATË 29.02.2024 "PËR DHËNIEN E DAKORTËSISË PËR VIJIMIN E PROÇEDURAVE, PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KONTRATË QIRAJE TË SIPËRFAQES SË FONDIT PYJOR NË PRONËSI TË BASHKISË LEZHË, PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARIVE TË PARASHIKUARA NË LEGJISLACIONIN NË FUQI PËR PYJET".

Data dhe vendi i mbajtjes së takimit: 14.10.2026, ora 11:00, në sallën e Bibliotekës "At` Gjergj Fishta" LEZHË

Pjesëmarrësit në takim nga ana e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore:

1. Zv.Kryetari i Këshillit Bashkiak Z. Agostin Marku.
2. Anëtar i Këshillit Bashkiak Z. Gjon Marku.
3. Përgjegjësi i Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave Z. Artan Palushi.
4. Sekretari i Këshillit Bashkiak Znj. Florida Çunaj.
5. Administrator i Njesisë Administrative Ungrej Z. Agustin Zefi.

Territori që mbulon konsultimi publik: Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor rezulton se sipërfaqja qe propozohet të jepet në përdorim është **5.54 ha**, për vendosjen e Aerogjeneratoreve + **10.7 ha** sipërfaqe pyjore për vendosjen e paneleve diellore (fotovoltaikëve) + **8.78 km** gjatësi rruge + **0.81 km** gjatësi linjë elektrike mund të jepen në përdorim dhe shtrihen në ngastrat/nëngastrat: **4a, 4b, 5, 6a, 6b, 8b, 9, 13b 14b, 15b, 16b, 17b, 18b, 19b, 20b, 21c, 22b, 23a dhe 29** në Ekonominë Pyjore **"Zadrimë"**e shtrirë në Njësinë Administrative Blinisht dhe ngastrat/nëngastrat **78, 79, 80, 81, 82 në** Ekonominë Pyjore **"Brinjat e Kreshtës"** e shtrirë në Njësinë Administrative Ungrej, Bashkia Lezhë.

Numri i Personave që marrin pjesë në takim: 28 .

Numri i femrave që marrin pjësë në takim: 9 femra.

Çështja 1 për diskutim: Proçedura e dhënies në përdorim të sipërfaqeve për ndërtimin e aerogjeneratorëve dhe impianteve fotovoltaike, si dhe përdorimin e rrugëve automobilistike dhe linjave elektrike.

Shoqëria **KIRAÇ GREEN ENERGY** shpk ka dorëzuar kërkesën e datës 23.07.2026 për rishikim/ndryshim të vendimit të Këshillit të Bashkisë Lezhë numër 18 datë 29.02.2024. Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave në Drejtorinë e Bujqësisë Ujitjes dhe Administrimit të Pyjeve, Bashkia Lezhë, pasi shqyrtoi kërkesën i ka kërkuar shoqërisë plotësimin e dokumentacionit lidhur me hartat e sipërfaqeve mbi të cilat mendohet të zhvillohet parku eolik dhe fototvoltaik, përfshirë infrastrukturën ndihmëse(rrugë auto dhe linja elektrike). Kjo shoqëri i është drejtuar Bashkisë Lezhë më një kërkesë në vitin 2024, për marrjen në përdorim të disa sipërfaqeve në zonën e Zadrimës dhe Ungrejt për ndërtimin e parkut eolik dhe nëpërmjet vëndimit numër 18 datë 29.02.2024, Këshilli i Bashkisë Lezhë ka dhënë miratimin për përdorimin e sipërfaqeve të kërkuara për ndërtimin e parkut eolik. Më pas kjo shoqëri i është drejtuar Komitetit të Investimeve Strategjike për të marrë statusin e investitorit strategjik dhe me këtë rast ka ndryshuar projektin në këtë zonë, pasi ka planifikuar të ndërtojë një park të integruar energjetik për të cilin ka paraqitur studimin dhe hartën e re për vendosjen e aerogjeneratorëve, paneleve diellore, rrugëve të aksesit dhe rrjetin elektrik. Sipërfaqet e kërkuara në kërkesën e sipërcituar ndryshojnë projektin dhe lidhur me këtë fakt lind nevoja e rishikimit të vendimit të Këshillit të Bashkisë për sa i përket ndryshimit të sipërfaqeve të kërkuara dhe vlerës që rezulton nga sipërfaqet që pretendon të marrë në përdorim.

Çështja 2 për diskutim:

1. Cili është ndikimi konkret që ka në pyje dhe në mjedis ky projekt në këtë zonë?
2. Ku do vendosen panelet dhe aerogjeneratorët pasi në hartë nuk është e qartë?
3. Cilat janë përfitimet e banorëve të zonës nga ky projekt?

Z. Gjon Marku, banor

1. Në fazën e përzgjedhjes së kompanisë zbatuese të këtij projekti do të administrohet Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis dhe Leja Mjedisore në të cilat do të qartësohen ndikimet në mjedis.

2. Në dokumentacionin e ngarkuar në Web-in e Bashkisë Lezhë janë përcaktuar qartë vendosja e aerogjeneratorëve dhe fotovoltaikëve sipas hartës pyjore të paraqitur. Gjithashtu janë cilësuar të gjitha parcelat pyjore sipas ekonomive pyjore respektive që preken nga zbatimi i këtij projekti.

3. Të ardhurat që përfitohen nga dhënia në përdorim i kthehen për riinvestim zonës pyjore që preket nga zbatimi I projektit, kjo në përputhje me ligjin 57/2020 "Për Pyjet". Gjithashtu kompania zbatuese do të paguajë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe taksa të tjera të cilat përfshihen në

buxhetin e bashkisë për shërbime dhe investime në komunitetet e të dy zonave ku mendohet të zbatohet projekti.

Z. Artan Palushi

Çështja 3 për diskutim:

1. A përfshihet fshati Fregen në këtë projekt?

Z. Mark Gjoka, banor

1. Fshati Fregen nuk përfshihet në këtë projekt.

Z. Artan Palushi

Çështja 4 për diskutim:

1. Cilat janë gjurmët e projektit, duhet të jenë gjërat më të detajuara, ndikimi dhe përfitimi.

Z. Pashk Luka, banor

1. Në dokumentacionin e ngarkuar në Web-in e Bashkisë Lezhë janë përcaktuar qartë vendosja e aerogjeneratorëve dhe fotovoltaikëve sipas hartës pyjore të paraqitur. Gjithashtu janë cilësuar të gjitha parcelat pyjore sipas ekonomive pyjore respektive që preken nga zbatimi i këtij projekti.

Z. Artan Palushi

Çështja 5 për diskutim:

1. Ku do bëhet ky investim?
2. Nëse investimi bëhet në atë vend , pse dëgjesa bëhet në qytet dhe jo në fshatin përkatës?
3. Kush është perfituesi?

Z. Kolë Zefi, banor

1. Në dokumentacionin e ngarkuar në Web-in e Bashkisë Lezhë janë përcaktuar qartë vendosja e aerogjeneratorëve dhe fotovoltaikëve sipas hartës pyjore të paraqitur. Gjithashtu janë cilësuar të gjitha parcelat pyjore sipas ekonomive pyjore respektive që preken nga zbatimi i këtij projekti.
2. Është vendosur që të gjitha dëgjesat publike , në rastin kur preken dy apo më shumë njësi për të njëjtën çështje të zhvillohen në qëndër të Bashkisë.
3. Të ardhurat që përfitohen nga dhënia në përdorim i kthehen për riinvestim zonës pyjore që preket nga zbatimi I projektit, kjo në përputhje me ligjin 57/2020 "Për Pyjet". Gjithashtu kompania zbatuese do të paguajë taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe taksa të tjera të cilat përfshihen në buxhetin e bashkisë për shërbime dhe investime në komunitetet e të dy zonave ku mendohet të zbatohet projekti.

Z. Artan Palushi

Çështja 6 për diskutim:

1. A janë njoftuar banorët e dy Njësive dhe si?

Z. Alfred Nikolli, banor

1. Është bërë njoftimi sipas procedurave standarte, gjithashtu i është derguar shkresë njësive administrative për njoftimin e kryetarëve të fshatrave dhe përfaqësuesve të komunitetit në lidhje me dëgjesën.

Z. Artan Palushi

Çështja 7 për diskutim:

1. Pse nuk ka një projekt konkret, duhet të ketë Vlersim Ndikimi në Mjedis?

Z. Danjel Kuçaj, banor

1. Në momentin që hapet gara e ankandit, kompanitë e interesuara do dorëzojne dokumentacionin e kërkuar sipas ligjit , ku pjesë e tij është dhe projekti I plotë I zbatimit si dhe VNM përkatëse.

Z. Artan Palushi

Çështja 8 për diskutim:

1. Për sa vjet jepen këto investime strategjike?

Z. Pal Gjeta, banor

1. Dhënia në përdorim e sipërfaqeve pyjore për zhvillimin e aktiviteteve që parashikon ligji ka një afat maksimal për 10vjet, në përputhje me Planin e Mbarështimit të ekonomisë pyjore.

Z. Artan Palushi

Struktura përgjegjëse

për mbajtjen e proces-verbalit :

ARTAN PALUSHI

SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

FLORIDA ÇUNAJ











